



Rregullat për prokurim të Shërbimeve të veçanta (Konsulentët / Kontraktorët individual)

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.8 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe në pajtim me Nenin 84 të Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06-L-114, nxjerr Rregullat për udhëheqjen e aktiviteteve të prokurimit për shërbime të veçanta.

Neni 1 Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtyre Rregullave është që të definohen hapat të cilët duhet të ndiqen për udhëheqjen e një procedure për sigurim të Konsulentëve / Kontraktorëve Individual për Shërbimeve të veçanta.

Neni 2 Termet e përdorura

Termet e përdorura në këta Rregulla kanë të njëjtin kuptim siç përmendën në Nenin 4 (Definicionet) të Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, tani e tutje “LPP”.

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e Shërbimeve të veçanta të cilët nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06-L-114. Shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por që nuk i plotëson kërkesat me stafin që e ka.

3.2 Konsulenti / Kontraktori individual është një specialist në një fushë specifike, i angazhuar nga Autoritet Kontraktues në rolin e një këshilluesi.

3.3 Për shërbime Konsulente individuale mund të ofertojnë vetëm personat fizik nga të cilët nuk kërkohet që të kenë biznes të regjistruar por personi fizik duhet të posedoj Numrin Fiskal.

3.4 Rregullat e përcaktuara në nenin 59 të “Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik”, tani e tutje “RUOPP”, aplikohen për kontraktimin e Kompanive Konsulentë, ndërsa këto rregulla vlejné për kontraktimin e personave siç përkufizohet në nenin 4.1.38 të LPP-së.

3.5 Kontraktimi i Konsulentëve Individual bëhet përmes procedurave të prokurimit të LPP, kontratë publike për shërbime me kriter të shpërblimit “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”. Në varësi të vlerës së parashikuar, Autoriteti Kontraktues përzgjedh llojin e procedurës dhe përcakton afatet kohore për dorëzim të tenderëve siç përkufizohet në dispozitat e LPP-së.

3.6. Kohëzgjatja e kontratave për shërbime të veçanta nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë e gjashtë (36) muaj.

Neni 4

Shërbime Konsulentë individuale

4.1 Procedura fillohet me publikimin e njoftimit për kontratë, në platformën elektronike, të përgatitur në përputhje me nenin 40 të LPP-së dhe me ngarkimin e Dosjes së tenderit të miratuar nga KRPP.

4.2 Për publikimin e njoftimit për kontratë Nenet 47.6-47.7 të RUOPP zbatohen ngjashëm.

4.3 Dosja e tenderit duhet të shkarkohet nga personat e interesuar nga platforma e prokurimit elektronik.

4.4 Për Informata sqaruese ose shtesë Nenet 47.10-47.14 të RUOPP zbatohen ngjashëm.

4.5 Hapja e tenderëve bëhet në përputhje me nenin 36 të RUOPP.

4.6 Vlerësimi i tenderëve duhet të kryhet menjëherë duke marr parasysh disa kriterë, të tilla sikurse:

- i. përvoja përkatëse e këshilltarit;
- ii. cilësia e metodologjisë së propozuar;
- iii. kualifikimi; dhe/ose
- iv. transferimi i dijenisë, nëse kërkohet.

4.7 Secili kriter duhet të notohet dhe pastaj notat duhet të radhiten që të bëhen pikë. Sistemi i radhitjes duhet të përcaktohet në dosjen e tenderit.

4.8 Kriteret që duhet të përdoren për vlerësimin teknik si dhe peshat treguese janë si më poshtë. Peshat mund të rregullohen që tu përshtaten prokurimeve specifike:

Kriteret	Pesha
Përvojë specifike	20-50
Përshtatje e metodologjisë/planit të punës	20-50
Kualifikimi	20-40
Transferimi i njohurisë (opsionale)	0-10
Pikët totale	100

4.9 Piket totale do të fitohen duke bashkuar **piket teknike** dhe **financiare**. Notat e “kostos” duhet të përzgjidhen duke marr parasysh ndërlikueshmërinë e objektit të kontratës që duhet dhënë si dhe rëndësinë përkatëse të cilësisë. Rezultati i peshuar i propozimit financiar duhet të specifikohet në Dosje të Tenderit, dhe mund të jetë deri në 30 pikë.

4.10 Pas identifikimit të tenderit më të mirë, Zyrtari i Prokurimit, duhet që të përgatitë Formularin B58 “*Njoftimin mbi vendimin e AK*” dhe ta ngritë në Platformën e prokurimit elektronik - si dokument shtesë nëpërmjet funksionit “**shtoni dokument të ri**”, pret skadimin e intervalit kohor, *gjatë të cilit ofertuesit mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.

4.11 Dispozitat e Neneve 47.34 – 47.37 të RUOPP aplikohen në mënyrë të krahasueshme për dhënie të kontratës, nënshkrim si dhe për shpërndarjen e kontratës së nënshkruar.

4.12 Pjesa IX, Procedurat e shqyrtimit të prokurimit, e LPP aplikohet për shqyrtim të ankesave.

Neni 5 **Hyrja ne fuqi**

5.1 Keto rregulla hyjnë në fuqi nga data e nënshkrimit.

22.09.2020

(data e nënshkrimit)



Osman Vishaj – Kryetar i KRPP-së